Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0574

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga. Isa Hasani-kryetarë duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Samire Osmani", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Kuvendi Komunal- Gjilan" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material Higjeniko – Sanitar" me numër të prokurimit 651-23-394-1-1-1, me 01/12/2023, mori:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE "Samire Osmani" me nr. 2023/0574 , e datës 14/08/2023, e paraqitur kundër vendimit AK "Kuvendi Komunal- Gjilan" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material Higjeniko -Sanitar" me numër të prokurimit nr.651-23-394-1-1-1.

2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, Kuvendi Komunal Gjilan, i datës 26.07.2023, për shpërblyer me kontratë "Consortium offishop Group & Ntp Vlora ", lidhur me aktivitetin e prokurimit,"Furnizim me material Higjeniko -Sanitar"nr. të prokurimit nr.651-23-394-1-1-1.

3. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës, ndaj Operatorit Ekonomik "Samire Osmani", konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.01.2023, "Kuvendi Komunal- Gjilan" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material Higjeniko – Sanitar" me numër të prokurimit 651-23-394-1-1-1. Ndërsa me datën 26.07.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë për "Consortium offishop Group & Ntp Vlora ".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës, furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 126,836.80 €.

Me 30.07.2023, OE "Samire Osmani" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 02.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 14.08.2023,OSHP,ka pranuar ankesën nga OE "Samire Osmani" me nr. 574/23 lidhur me aktivitetin "Furnizim me material Higjeniko- Sanitar" me numër të prokurimit 651-23-394-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Ankesa e operatorit ekonomik "Samire Osmani".

Ankuesi pretendon se AK-Komuna e Gjilanit ka përzgjedhur për ta shpërblyer një operator ekonomik i është me çmim me te larte rreth 11 mije se sa ne qe kemi ofertuar dhe kjo paraqet shkelja e rend e ligjit te LPP-se dhe nuk i ka marr parasyshe ofertën ton me çmim me te ulte ne rivlerësim.

Po ashtu OE pohon se AK ne vendim e datës 26.07.2023 dhe po ashtu ne Vendimin për Rishqyrtim te datës 02.08.2023 ne Arsyetim për Refuzim nuk me është kërkuar sqarime për pozicioni me numër rendor 30. Nje ashtu une ju kam përgjigjur sqarimeve te kërkuara AK e me date 23.03.2023, për pozicionet me numër 14,15,16 dhe 60 ne përmes faktuarve te blerjes i kemi dëshmuar AK se edhe pse i është dukur çmimin jo normalisht i ulet i kemi dëshmuar qe fitimin e kemi mbi 60 % për çdo pozicion e qe është çmimin jashtëzakonisht i larte

OE pohon se Goe Consortium Offishop Group Shpk & Ntp Vlora edhe pse me çmim ka qene mbi 11 mije euro me i shtirjet se ne është shpallur fitues kundërligjshëm pasi qe anëtari i konserciumit NTP VLORA konkretisht është futur ne konsercium si emër tregtar ndërsa biznes real është Adnan Krasniqi B.I me adrese Prishtine ,L.Dardania -RR.Bi Dëshmorëve me Numër Unik te Biznesit 810468860 pronar ka qene Adan Krasniqi i cili tashme është i ndjere

OE duke u referuar pretendimeve si më sipër "Samire Osmani" konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vendosur ne kundërshtim me; Neni 48 pika 1,2,3 dhe 4 e Ligjit për Shoqëri Tregtare. ,Neni 1 paragrafi 1,2 dhe 3 ,Neni 2 ,Neni 6 paragrafi 1 dhe 2, Neni 7, Neni 56, Neni 59, Neni 60, Neni 65, Neni 66 të LPP .

-Administrimi dhe vlerësimi i provave

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16/08/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 574/23, ndërsa me datë 28/08/2023 është dorëzuar raporti i

ekspertit me nr. 2023/0574 me rekomandimin për panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, "Autoriteti kontraktues nuk pajtohet, ndërsa OE pajtohet me raportin.

Raporti i ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimet kryesore ankimore të OE kane të bëjnë me eliminimin e ofertës së tij, pas procesit të rivlerësimit fillestar te ofertave përkatësisht njoftimin mbi rezultatin nga aktiviteti i prokurimit të publikuar nga AK Gjilan . AK si arsyetim të eliminimit ka përcaktuar se OE ankues "Samire Osmani", për disa nga pozicionet e caktuar ka ofertuar me çmime Jo Normalisht te ulëta siç përcaktohen me nenin 61 te LPP-se. OE ankues përmes deklaratës ne ankese dhe përmbajtjes tekstuale te saje, kryesisht ka përshkruar vargje dhe fraza me karakter te vërejtjeve, leksioneve dhe kërcënimeve për mënyrën e zhvillimit dhe procesit te vlerësimit dhe rivlerësimit te kësaj procedure te prokurimit dhe shume pak i është referuar objektit te kontestit.

AK sipas letrës standarde dhe arsyetimit te eliminimit të OE ankues rezulton qe ka përshkruar pozicione te përmasës dhe i ka konsideruar ato pozicione si çmime Jo Normalisht te ulëta pa kërkuar sqarim fare ndaj OE ankues. Shembull pozicioni nr. 30 i përmasës dhe para llogarisë.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor kundër OE të rekomanduar për dhënie të kontratës sa i përket anëtarit te grupit te OE NTP "Vlora", OE ankues i referohet dispozitave ligjore te ligjit për Shoqëri Tregtare, përkatësisht pohon se pronari i te njëjtit biznes ka ndërruar jete dhe bashke me ta shuhet edhe vete biznesi. Sipas certifikatës se regjistrimit te biznesit e ngarkuar në oferte rezulton qe kemi te bëjmë me biznes individual por eksperti shqyrtues nuk posedon kurrfarë prove lidhur me faktin se nëse pronari i te njëjtit biznes ka ndërruar jete, por statusi i biznesit ne ARBK i njëjtë rezulton te jete aktiv.

Prandaj, eksperti shqyrtues sipas asaj qe u përshkrua me lartë dhe ne kuptim te nenit 59 dhe 72 te LPP-se, vlerëson se ky proces i prokurimit duhet te kthehet ne rivlerësim ne atë mënyrë qe AK ti aplikoj ne tersi dispozitat e nenit 61 te LPP-se, si dhe nenit 41 te RRPP-se, sa i përket çmimeve dhe pozicioneve te cilat mund te duken apo edhe janë si Jo Normalisht te ulëta, ndërsa lidhur me qeshjen e vdekjes se pronarit te biznesit individual te kërkohet sqarim apo te konsultohet baza ligjore nëse biznesi mund te trashëgohet si tërësi, mund te trashëgohen vetëm asetet apo me vdekjen e pronarit shuhet edhe vete biznesi, konkretisht te kërkohet sqarim nga anëtari i grupit NTP "Vlora", lidhur me statusin e biznesit me qe ne ARBK biznesi i njëjtë rezulton te jete aktiv."

-*Seanca shqyrtuese.*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116

të LPP.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues.

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material Higjeniko – Sanitar" me numër të prokurimit 651-23-394-1-1-1.

Paneli shqyrtues lidhur me pohimet ankimore të OE se AK nuk e ka shqyrtuar ankesën e tij, vrenë se AK me vendimin e , datës 02.08.2023 e ka shqyrtuar ankesën e palës "Samire Osmani B.I" të paraqitur më datën 30.7.2023, kundër Njoftimit për vendimi e AK-së të datës 26,,7,2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me materialo-higjenik-sanitar" nr.prokurimit;651-23-394-1-1-1. AK, përmes formës standarde te KRPP-së, me kërkesë për sqarime të tenderit i është drejtuar OE ankues për sqarim të disa nga pozicioneve të paramanës duke i konsideruar ato si çmime Jo Normalisht te ulëta dhe pas marrjes se përgjigjes nga OE, ka marr vendim për refuzimin e ankesës se OE ankues.

Paneli shqyrtues nga përshkrimi si më larte konstaton se AK ka vepruar në përputhje me ligjin nenin 61 te LPP-së dhe 41 i Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022, ka sqaruar me OE ofertën me çmime Jo Normalisht të ulëte dhe me pastaj ka marr vendimin sipas diskretcionit dhe bindjeve faktike, andaj pohimi ankimor i palës se AK, nuk e ka shqyrtuar ankesën e tij, është i pabazuar.

Paneli shqyrtues lidhur me pohimin ankimor se OE i rekomanduar NPT'VLORA, nr. biznesit 810468860, se pronari i tij Adnan Krasniqi tashme është i ndjere, ndërsa tani figuron si agjente e regjistruar Vlora Krasniqi, këtë pretendim e ka trajtuar eksperti shqyrtues dhe ka konstatuar se i njëjti biznes është aktive dhe i regjistruar ne ARBK. Po ashtu në dosjen e ofertës të OE të rekomanduar NPT "VLORA" vërehet se është certifikata e regjistrimit të biznesit në ARBK , e datës 06.06.2021, andaj pohimet ankimore të palës ankuese janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues duke u bazuar nga të gjitha faktet, arsyet dhe gjendjen faktike që u përshkrua si më sipër, PSH konstaton se Autoriteti kontraktues duke i vlerësuar tiparet kryesore të LPP-së, që janë ekonomociteti, efikasiteti dhe kursimi i buxhetit të shtetit, ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE, me çmimin ekonomik, oferta prej 81.885,37 euro, derisa njashtu AK, për ketë

aktivitet prokurimi ka paraparë buxhet mjete në shumen prej 126.836,80 euro.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë të paqëndrueshme ashtu siç janë dhënë në konstatimin e panelit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- OE - **Samire Osmani**
- Arkivës së OSHP-së: